

VENDIM

Nr.735, datë 1.11.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.622, DATË 12.11.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E ZONAVE, KU MUND TË HAPEN KAZINO", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 13 të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.622, datë 12.11.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Kudo në vendim emërtimi "Ministria e Financave" zëvendësohet me "Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës".
 2. Kudo në vendim emërtimi "Ministria e Rendit Publik" zëvendësohet me "Ministria e Brendshme".
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha